

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALASNr. 229 / Prot.Tiranë, më 08.02.2024**KANDIDATËT QË PLOTËSOJNË KRITERET PARAPRAKE PËR THIRRJEN
SHPALLJE NJOFTIMI PËR 1(NJË) VEND TË LIRË PUNE NË QENDRËN E SHËRBIMIT
TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE FIER, PËR PERIUdhËN JANAR-GUSHT 2024"**

Komisioni për zhvillimin e procesit të konkurimit për 1(një) vend të lirë pune në Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Fier, për periudhën Janar-Gusht 2024", ngritur me Urdhrit nr. 3/ datë 18.01.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, u mbledh më datë 08.02.2024, me qëllim shqyrtimin e aplikimeve, sa i përket përmbushjes së kërkesave të posaçme dhe dokumentacionit sipas thirrjes së publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas si dhe në bazë të Urdhrit nr. 53 datë 26.05.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas "Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të kandidatëve për punonjës pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore".

Nga verifikimi në protokoll, rezulton se për vendin vakant pranë Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Fier kanë shprehur interes **2 (dy) aplikantë** si vijon:

1. **Zj. Katerina Matollari** (kërkesa me nr. 203 prot datë 17.01.2024, me anë të shërbimit postar);
2. **Zj. Sara Aliaj** (kërkesa me nr. 123 prot datë 10.01.2024, dorazi);

Pas shqyrtimit të dosjeve personale të aplikantëve, sipas metodologjisë së vlerësimit, Aneks-it 1 të miratuar me urdhërin nr. 53, datë 26.05.2021 "Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të kandidatëve për punonjës pranë qendrave të shërbimit të ndihmës parësore", komisioni vendosi që aplikanti i cili nuk plotëson kriteret për të vazhduar procesin e konkurimit (sipas rendit alfabetik) është:

1.Zj. Katerina Matollari

Arsyet e skualifikimit: Referuar kriterëve të posaçme për shpalljen: 1(një) vend vakant për Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Parësore Fier për periudhën Janar-Gusht 2024, kandidatja nuk ka dokumentacion që vërteton se plotëson kriterin e eksperiencës: jo më pak se një vit eksperiencë në punë si jurist/avokat (mungon librezë e pune dhe vërtetim i kontributeve shoqërore).

Pas shqyrtimit të dosjeve personale të aplikantëve, sipas metodologjisë së vlerësimit, Aneks-it 1 të miratuar me urdhërin nr. 53, datë 26.05.2021 "Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit

• të kandidatëve për punonjës pranë qendrave të shërbimit të ndihmës parësore”, komisioni vendosi që aplikanti i cili plotëson kriteret për të vazhduar procesin e konkurimit (sipas rendit alfabetik) është:

2. Zj. Sara Aliaj

Aplikanti i kualifikuar për shpalljen: “Njoftim për 1(një) vend të lirë pune në Qendrën e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Fier, për periudhën Janar-Gusht 2024”, duhet të paraqitet pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas për t’u nënshtruar provimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë.

❖ **Provimi me shkrim** do të zhvillohet më datë **12.02.2024, ora 10:00**, pranë ambienteve të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

Provimi me shkrim do të zhvillohet mbi:

- Njohuri të thelluara mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, Ligjin nr.111/2017, kushtet dhe kërkesat e ligjit për të përfituar nga shërbimet e ndihmës juridike falas;
- Njohuri të plota teorike dhe praktike mbi legjislacionin dhe të drejtën civile, penale dhe administrative.

❖ **Intervista e strukturuar me gojë** do të zhvillohet më datë **12.02.2024, ora 11:30**, pranë ambienteve të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

Intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet mbi:

- Njohuritë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e punës, eksperiencën e mëparshme, motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Mos paraqitja e kandidatëve në datën e orën e caktuar passjell skualifikimin.

Adresa: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, Rruga “Jordan Misja”, Njësia Bashkiake nr. 9, Godina nr.3, Tiranë

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ergys Qirici

